



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

AD.GJTHM.nr.05/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur ne çështjen disiplinore të ngritur ndaj I.G, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovice-Dega në Vushtrri-Divizioni civil, duke vepruar sipas ankesës disiplinore te parashtruar nga përfaqësuesi i propozues G. A- av.V.H nga Prishtina, pas vlerësimit te ankesës së parashtruar nga përfaqësuesi i propozueses dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit I.G tw dt.12.05.2023, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 25.05.2023, merre këtë;

A K T V E N D I M

REFUZOHET Ankesa disiplinore e dt.12.05.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.05/2023, e parashtruar nga përfaqësuesi i propozueses G.A-A av. V.H nga Prishtina, kundër Gjyqtarit **I.G**, Gjyqtar pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë Dega në Vushtrri-Divizioni civil, e **PA BAZUAR**.

Arsyetim

Në cilësinë e Nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me dt.12.05.2023, kam pranuar ankesën nga përfaqësuesi i propozueses G.A-A av. V.H nga Prishtina, kundër I.G, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë –Dega në Vushtrri-Divizioni civil.

Përfaqësuesi i propozues G.A-A av.V.H, në ankesë ka ngritur çështjen e vendimmarrjes ne lenden e caktuar te gjyqtarit I.G, i cili ka refuzuar me aktvendim C.nr.465/23 të dt.31.03.2023 propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Sipas ankesës se parashtruara nga përfaqësuesi, i njëjti ka theksuar se gjyqtari i çështjes i kishte të gjitha provat për ta vendosur masën e përkohshme të sigurisë në favor të propozueses, mirëpo gjyqtari veproj jo në proporcion me nenin 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së, po ashtu ne ankesë ka theksuar se uzurpatori A.A pasi u cilësua se nuk qenka uzurpator sipas aktvendimit të gjyqtarit I.G C.nr.465/2023, ka marrë forcë dhe me dt.25.04.2023 në qytetin e Vushtrrisë bashkë me vëllain e tij, e kanë kërcënuar me jetë, për çka edhe ka hapur rast ndaj tij.

Autoriteti kompetent ne rastin konkrete, ka marre veprime procedurale pas pranimit te ankesës, ka inicuar procedurën disiplinore ndaj subjektit te hetimit-gjyqtarit, i cili gjyqtar ka dhënë deklarat me shkrim dt.12.05.2023, lidhur me ankesën e përfaqësuesit të propozueses G.A-A av.V.H, ka theksuar se propozuesja përmes të autorizuarit të saj me dt.30.03.2023 ka paraqit propozimin për caktimin e masës

së përkohshme të sigurimit kundër kundërshtarit A.A nga fshati Gojbulë, Komuna Vushtrrisë parcelat katastrale nr.00588-0 dhe 00589-0 që të dyjat në fshatin Gojbulë, Vushtrri.

Pas shqyrtimit të kërkesë së propozueses kërkesa si e tillë është konsideruar e pabazuar dhe është vendosur me aktvendim C.nr.465/23 të dt.31.03.2023 me të cilin aktvendim i është refuzuar kërkesa për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe ndalimin e shitjes dhe tjetërsim të parcelave katastrale P-00588-0 dhe P-00589-0 kundër kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit A.A, për shkak se kundërshtari i masës nuk mund ti shes apo të tjetërsoj pa qenë pronar si rrjedhojë edhe kërkesa e propozueses i është refuzuar. Andaj në bazë të lartcekurave kërkoj që ankesa të refuzohet e pabazuar, sepse në raste të ngjashme sikurse ankuesi tani mund të ankohet çdo palë në çdo lëndë që e zgjedhim, sepse gjithmonë njëra palë mund të jetë e pa kënaqur me vendosjen, mirëpo për këtë ekziston Gjykata e Apelit, si instancë e dytë, ndërsa ne rastin konkret Gjykata ka marrë Aktvendimin C.nr.465/23, dt.31.03.2023, me udhëzimin për te drejtën ne ankese, përfaqësuesi nuk ka paraqit ankese ndaj aktvendimit, si e drejte ligjore e palës.

Kryetari i Gjykatës (ne rastin konkret nënkryetari i Gjykatës ne mungese te kryetarit) në cilësinë e autoritetit kompetentë sipas Ligjit për përgjegjësitë disiplinore për Gjyqtare dhe Prokuror, ka vlerësuar ankesën e përfaqësuesit te palës ne procedure, av.V.H dhe ka gjet se pretendimet janë në raport me gjyqtarin e çështjes dhe pakënaqësitë qe i ka shprehur lidhur vendimmarrjen e gjyqtarit të çështjes ne lenden C.nr.465/23.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësisë disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, janë te pa qëndrueshme, nuk kemi një dyshim te qëndrueshëm për veprime te mëtejme, duke marrë për bazë edhe përgjigjen e marrë nga gjyqtari ndaj të cilit është ngritur procedura disiplinore, i cili në mënyrë permbajtësore ka shpjeguar veprimet e ndërmarra lidhur me lëndën C.nr.465/23 dhe arsyet e refuzimit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe ndalimin e shitjes dhe tjetërsim të parcelave katastrale pasi që kundërshtari i masës nuk mund ti shes apo tjetërsoj pa qenë pronar i tyre. Se çështje e vendosjes lidhur me lëndën i përket gjyqtarit të çështjes dhe ndaj aktvendimit pala ka të drejte ankese, si e drejte ligjore e secilës palë në shfrytëzimin e mjeteve juridike, si ato të rregullta dhe te jashtëzakonshme, që janë në dispozicion të palëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe pakënaqësitë e palëve te marrja e vendimit nga ana e Gjykatës si shkallë parë, nuk mund të konsiderohen edhe shkelje disiplinore.

Janë te paqëndrueshme deklaramet ne ankesën disiplinore se me veprimet e tij gjyqtari i ndihmoj uzurpatorit te ndihet i lire ne uzurpim dhe tani uzurpatori thirret dhe mbështetet ne aktvendimin e tillës se nuk ka qene uzurpator.Çështja dhe emërtimi i fjalës uzurpim i përket procedurës penale dhe nga shkresat e lendes vërtetohet se me dt.04.04.2023, përfaqësuesi i palës av.V.H, pranë Prokurorisë Themelore Mitrovicë ka parashtruar kallëzim penale ndaj te pandehurit A.A, për veprën penale Uzurpim i paligjshëm i pronës se huaj nga neni 320 par.2 te KPRK-es dhe te veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 te KPRK-es, veprim te cilën e mbështesim si e drejt ee pales, për te cilën ne vlerësojmë se Prokuroria do te veproje ne shqyrtim te këtij kallëzimi penal, çështja e pronës përveç qe është çështja ligjore është edhe kategori kushtetuese sipas nenit 46, 121 te Kushtetues se Republikës se Kosovës, e drejta e pronës është e garantuar.

Subjekti i hetimit – gjyqtari ka dhënë rast konkrete ku ne një procedure lënda nr C.nr.299/19, me pale paditëse G.A-A dhe te paditur A.A, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses G.A-A dhe ka Vërtetuar se i padituri A.A, nga fsh.Gojbul Komuna e Vushtrrisë e ka penguar paditësen ne posedimin e lire dhe faktik te palujtshmerise e cila ndodhet ne ngastrën kadastrale P-702020018-00588 Z.K.Gojbulë ne sipërfaqe 22258m2, ne pjesën ideale 3/10,po ashtu duke e obliguar te paditurin A.A qe menjëherë te e largoj gypin

nga pusi i te paditëses ne parcelën P-702020018-00588, nen pasojë e përmbarimit te dhunshëm, nga kjo nënkupton se vendimmarrja eshte vetëm ne mbështet te gjendjes faktike baze te provave

Asnjë person-autoritë tjetër nuk e ka te drejtën e ushtrimit te ndikimit te gjyqtari me rastin e vendosjes se kërkesave nga palët ne procedurë, vendosja i përket gjyqtarit si e drejtë ligjore gjithmonë duke u bazuar ne prova dhe palët për pakënaqësitë e tyre e kane mundësin ligjore te ushtrimit te mjeteve ndaj vendimeve gjyqësore, marrja e një vendimi nga gjyqtari nuk mund te referohet ne nxjerrjeje te paligjshme te vendimit, pasi qe ekzistojnë shkallëshemrite për shqyrtimin e vendimeve gjyqësore mbi ligjshmërinë apo paligjshmërinë e tyre me rastin e vendosjes.

Nga arsyet e theksuara me larte, ne mbështetje te nenit 9 par.6 te Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinorë te gjyqtarëve dhe prokuroret dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 te Rregullore per Procedurën Disiplinore te Gjyqtareve, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
AD.GJTHM.nr.05/2023, dt.25.05.2023

Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit av.V.H**
- 3. Gjyqtarit I.G**